



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/28
Datë: 28.08.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2.8. të Ligjit Nr. 03/L-190 për Gazetën Zyrtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 dhe 75 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 gusht 2020, merr këtë:


V E N D I M

Për publikim të akteve nënligjore të Qeverisë dhe ministrive në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës

1. Me qëllim të rritjes së transparencës dhe sigurisë juridike, përkatësisht parashikueshmërisë së hyrjes në fuqi të akteve nënligjore në përputhje me Aktvendimin për Papranueshmëri Nr. ref.:RK1010/16 në Rastin KO89/16, Parashtrues Komuna e Prishtinës "Vlerësim i kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015, të Ministrisë së Shëndetësisë", të 15 majit 2015, pezullohet neni 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.14 dhe Shtojca 9 e Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, deri në ndryshimin dhe plotësimin e nenit përkatës të këtij udhëzimi administrativ.
2. Aktet nënligjore të Qeverisë dhe ministrive të publikohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;
3. Rregulloret dhe udhëzimet administrative hyjnë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare, përveç nëse, me vetë aktin e tillë nuk përcaktohet ndryshe;
4. Vendimet dhe urdhëresat hyjnë në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare, përveç nëse, me vetë aktin e tillë nuk përcaktohet ndryshe.
5. Obligohen institucionet e cekura sipas pikës 2 të këtij vendimi, që aktet e tyre nënligjore, t'i procedojnë për publikim në Gazetën Zyrtare, në afatin e përcaktuar sipas nenit 7, paragrafi 7 të Ligjit për Gazetën Zyrtare (G.Z.nr.74/2010, dt.20.07.2010), përveç nëse, me vetë aktin nënligjor nuk përcaktohet ndryshe.
6. Institucioni i cili ka dërguar aktin nënligjor për publikim, mban përgjegjësi për pasaktësi, parregullsi, gabime në përmbajtjen e aktit nënligjor, mospërputhshmëri në përkthimin e akteve ose pengesë tjetër ligjore për publikim.
7. Me këtë vendim, autorizohet Zyra Ligjore në bashkëpunim me Zyrën për Publikimin e Gazetës Zyrtare në Zyrën e Kryeministrit, të përgatis dhe t'ia propozojë Qeverisë për miratim Projekt Udhëzimin Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative.

8. Obligohet Zyra e Kryeministrit, ministritë dhe institucionet e tjera përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.
9. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë